



المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondazioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të A ll-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

ARKA LUFTARAKE

Ahmed Deedat

Botuar nga: (e pabotuar ende. Te interesuarit për botim mund të lajmërohen në tel: +377 44 360 591)

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë përkthyesit: Astrit Ibrahim

HYRJE	6
SI TË PËRDORËT ARKA LUFTARAKE	6
1.ABRAHAMI : E KA MARTUAR MOTRËN E VET(<i>SARA</i>) (?).....	8
2. ABSURDET : NË LIBRËN E ZOTIT (?) , BIBLËN E SHENJTË :	9
3. ALKOOLI : KËSHILLË E DREQIT NË LIBRIN E ZOTIT (?).....	11
4. ARABËT DHE ARABIA: NË BIBLËN KRISHTERE –	12
5. BAKA ËSHTË MEKA : KIBLA E SHENJTË E NDËRTUAR NGA PROFETI IBRAHIMI (P.M.Q.T) DHE DJALIT TË TIJ ISMAILIT (P.M.Q.T) ËSHTË NË MEKE	15
6. DAVIDI - NJERI I DASHUR NGA ANA E ZOTIT, KRYEN KRIM (TRADHËTI) BASHKËSHORTORE ME BATH-SHEBA, GRUAN E URIA HUT.....	16
7. DERRAT – MISHI I TYRE I NDALUAR	16
8. DJEMT E PERËNDISË – BIBLA CEK DJEMË TË ZOTIT ME TONELATA	17
9. DHUNIM – VËLLAU DHUNON DHE KRYEN INCEST ME MOTRËN E TIJ –	19
10. ELOHIM - NË HEBRAISHTË FJALË PËR FJALË DON TË THOTË "ZOTËRA".....	19
11. FJALA E ZOTIT – TË MOS HJEKET AS TË SHTOHET ASNJË FJALË.....	20
12. FRYMA E SHENJTË.....	20
13. GRATË – NDALOHEN TA HAPIN GOJËN E TYRE NË KISHË	22
14. GJENELOGJIA E JEZUIT.....	23
15. INCEST –	23
16. ISHMAELI APO ISAKU? :.....	26
17. HEBRENJTË – POPULL RREBEL	28
18. JEHOVAH :	29

19. JEREMIAH – PROFET I CAKTUAR PARA LINDJES SË TIJ	30
20. JERUZALEMI – PROSTITUTË E PANGOPUR –	31
21. JEZUSI (P.M.Q.T) : MRREKULLIA E PARË E TIJ NË BIBLËN E SHENJTË DHE NË KUR`AN-IN E SHENJTË:.....	31
22. JEZUSI (P.M.Q.T) "PERËNDI"? I PAFUQISHËM :!	36
23. JEZUSI (P.M.Q.T) (RACIST) – I DËRGUAR VETËM PËR HEBRENJTË !	38
24. JEZUSI (P.M.Q.T) – LAJME INTERESANTE	38
25. KETURAH : GRUAJA E TRETË E ABRAHAMIT	40
26. KOPIL – KJO FJALË NË BIBËL PËRDORËT VETËM TRE HERË	40
27. KUNDËRSHTIMET – NË BIBËL	41
28. KURVËRIA – SHIKO NËN "JERUZALEMI" NË PËRMBAJTJE	43
29. MASAKËR – NË DUART E HEBRENJËVE	43
30. MELKISEDEKU – KY PRIFT I LARTË I SALEMIT KA KUALITETE QË E MBISHËNDRRISIN JEZUS KRISHTIN (P.M.Q.T):.....	44
31. MESSIAH : PËRKTHYER "KRISHT"!.....	44
32. MËKATI I PARË (ORIGINAL SIN) –	46
33. MOHIMI – "...MOS IU NËNSHTRO ATIJ DHE MOS DËGJO (MOHO), SYRI YT NUK DUHET TË KETË MËSHIRË PËR KËTË, MOS E KURSE, MOS E FSHEH."47	
34. MUHAMMEDI (P.M.Q.T) – ËSHTË PROFET I VËRTETË SA I TAKON BIBLËS.....	48
35. ONANIZËM – "TËRHEQJE E PENISIT NGA VAGINA PARA EJAKULIMIT" (THE NEW COLLINS DICTIONARY). TERMI MJEKSOR – "COITUS INTERRUPTUS". :	49
36. PALI : NË PREZENCË TË TIJ BËHET DINAK, PËRDORË GËNJESHTRA :	50
37. PERËNDIA – PERËNDI ME KUALITETE TË PAHIJSHME –	50

38. PERËNDIA – ATRIBUTET E TIJ QË KUNDËRSHTOHEN NË MES VETE :	52
39. PERËNDIA – NUK ËSHTË SHKAKTARE E TRAZIRAVE, APO ...(?).	53
40. PERËNDIA : KONTRADIKTA TË MËTEJME TË KUALITETEVE TË TIJ :-	54
41. PERËNDIA – ME “P” TË VOGËL :	57
42. POLIGAMI – SOLOMONI I MENÇUR KISHTE MIJËRA GRA DHE KONKUBINA :	58
43. PROFECITË – KANOSJE TË ZBRAZËTA -	58
44. PROFETËT (POR LAKURIQ) : NËSE KËSHTU JANË PRIFTËRINJTË, ZOTI E BEKOFTË BRIMBULLIMIN E LIBRIT TË SHENJTË.	59
45. SABAT (E SHTUNE HEBRAIKE) SI FYERJE E PËRHERSHME E ZOTIT:	60
46. SARA – BIBLA E SHENJTË NUK E KURSEN AS PERËNDINË NGA SHPIFJET SEKSUALE TË PALIGJSHME QË I MVESHIN ATIJ :	61
47. SIDA DHE HOMOSEKSUALITETI - BIBLA E SHENJTË JEP SHKAK DHE ARSYE PËR KËTË KANCER DHE PARAZIT :	62
48. SKLLEVËRIA – E APROVUAR NGA ZOTI -	63
49. SODOMI – ARSYEJA E BIBLËS SE PSE NJERËZIT JANË SHËNDRRUAR NË LESBEIKA DHE HOMOSEKSUALË.	64
50. SYNET – (RRETHPRERJE): MARRËVESHJE EPËRJETSHME ME ZOTIN :	64
51. TRINITY - SA I PËRKET BESIMIT TË ATHANASIT :	65
52. VERA – SHIKO ‘ <i>ALKOOLIZMI</i> ’ NË PËRMBAJTJE.	66

HYRJJE

Nëse jeni serioz që të bëni Da`ve dhe takime me Krishterë të cilët përpiqen që t'i shëndrrojnë Mulimanët në të Krishterë, atëherë fito një kopje të “ARKËS LUFTARAKE” një version të përshtatshëm në madhësi xhepi, PA PAGESË.

Që të fitosh dobi maksimale nga ky udhëzues iu nevojitet një kopje e Biblës. Fito një kopje pa vonesë dhe mbaje kopjen tënde të “ARKËS LUFTARAKE” afër Biblës dhe përcjelli instrukcionet më tej.

SI TË PËRDORËT ARKA LUFTARAKE

Në kryqëzatë të mëtejme, bota Krishtere ka lëshuar “*Raketën e tyre të vrullshme*” (Biblën e Shenjtë) në dy mijë gjuhë të ndryshme. Vetëm për Arabët ata kanë botuar *Shkrimin e Shenjtë* në pesëmbëdhjetë dorëshkrime dhe dialekte të ndryshme.

Ky udhëzues do të ju mundësojë juve të ktheni “*Raketën e vrullshme Krishtere*” në “*Raketë Patriotike*”. Që të arrini këtë iu nevojiten pak ushtrime.

Hapi i parë që duhet të bëni është t`a merrni kopjen tuaj të Biblës. Së bashku me Biblën mbaje edhe fletushkën.

Përdore atë si një INDEKS.

Hapi i dytë të shiqosh në indeks.

Hapi i tretë selekto temën : psh. “INCEST – (Marëdhënie seksuale ndërmjet njerëzve që kanë lidhje gjaku). Këtë temë do ta geshë në faqen 15. Memorizo këtë dhe definicionin .

Tema e parë në titullin “INCEST” tregohet në Zanafilla 19:33-35. Njohu me vargjet. Rrethoi vargjet me laps të KUQ. Lartë fletës (në Bibël) shkruaj me ngjyrë të KUQE “*INCEST NË MES BABAIT DHE VAJZAVE TË TIJ*” poshtë faqes së njëjtë shkruaj numrin e faqes së shënimit tjetër në Biblën tuaj, psh. atë të Zanafilla 35:22. Në atë faqe shkruaje në fillim lartë – “*INCEST NË MES NËNËS DHE DJALIT*” , dhe rretho vargjet në të KUQE, kurse në fundin e faqes shkruaj numrin e faqes së shënimit të ardhshëm psh. Zanafilla 38:15-18. Gjeji versetet dhe rretho atë me të kuqe, dhe kompleto ushtrimin si në rastet 1 dhe 2 më lartë. Kështu je gati të ballafaqohesh me çdo trokitës të Biblës.

Pyeti misionarët, kur t`i ofrosh, definicionin e fjalës “INCEST”. Ndhimoi atyre në sqarim. Kërko prej tyre që të marrin Biblën e tyre dhe të lexojnë vargjet . Pyeti ata për moralin e tregimit. Nuk është aspak, pra është jomorale – kurse jomoraliteti në “*Librin e Zotit*”!?

Bën disa ushtrime me tema tjera si “Muhammedi (paqa dhe mëshira e All`llabut goftë mbi të).Përdore lapsin e gjelbër për tituj dhe rrethime të vargjeve. Për temën “KONTRADIKTË” përdore lapsin

e verdhë. Në këtë mënyrë mund të kesh një KOLOR BIBËL për misionarët krishterë të përgatitur si kurrë më pare.

Disa shkurtesa

KJV = King James Version

P.M.Q.T = Paqa Dhe Mëshira Qoftë Mbi Të

IPCI = Islamic Propagation Center International

[Shënimet në kllapa të mesme janë nga përkthyesi]

1.ABRAHAMI : E KA MARTUAR MOTRËN E VET(SARA) (?)

“... Pse më the (o Abraham) se ajo ishte gruaja juaj. Pse më the: “Është motra ime”? Kësisoj unë e mora sikur të ishte GRUAJA ime. Ja pra ku është gruaja jote; merre me vete (Sarën) dhe nisu !”

Zanafilla 12:18-19

“Pëveç kësaj ajo NË TË VËRTETË (Saraj) motra ime(!)... dhe pastaj u bë gruaja ime (e Abrahamit)”

Zanafilla 20:12

“Dhe kështu Saraj, gruaja e Abrahamit!...mori shërbyesën e saj Agarin, egjiptasën, dhe ia dha PËR GRUA burrit të saj Abrahamit.

Zanafilla 16:3

2. ABSURDET : NË LIBRËN E ZOTIT (?), BIBLËN E SHENJTË :

GOMARICA QË FLET(bisedon me Balaamin)

Numrat 22:27-28

Insekte me KATËR këmbë

Levitiku 11:20

Lindje e femrës PASTËRTI e dyfisht

Levitiku 12:1,2,5

Shamgari VRAU 600 Filistej me një hosten qesh

Gjyqtarët 3:31

Samsoni VRAU NJË MIJË NJERËZ me nofull gomari akoma të freskët

Gjyqtarët 15:15-16

Leopardi me SHTATË KRERË...

Zbulesa 13:1-2

Me hëngër JASHTËQITJEN dhe me pi URINËN (në Librin e Zotit (?))

2 Mbretërve 18:27 dhe Isaia 36:12

Me hedhë JASHTËQITJE në fytyrë...

Malakia 2:3

Të hashë BUKË me JASHTËQITJE ...

Ezekiel 4:12-15

Samsoni bëri SEKS me laviren në Gaza

Gjyqtarët 16:1

Ruthi FJETI me Boazin në grumbull të grurit

Ruth 3:4-5

Davidi plak FJETI me virgjinen e re

1 Mbretërit 1:1-3

3. ALKOOLI : KËSHILLË E DREQIT NË LIBRIN E ZOTIT (?)

“Jepni PIJE DEHËSE atij që është duke vdekur dhe VERË atij që e ka zemrën e hidhëruar

“Le të pijë (Verë) për të harruar varfërinë e tij dhe për të mos kujtuar më hallet e tij”

Fjalët e urta 31:6-7

Alkooli preferohet në vend të ujit !

“Mos pi më ujë, por përdor pak VERË për stomakun tend dhe për sëmundjet e tua të shpeshta

1 Timoteu 5:23

ÇKA THONË PËR KËTË AA (ALKOOLIKËT ANONIM)

Me miliona njerëz sot në botë luftojnë këtë sëmundje që është “*bekuar*” si bari efikas kundër stomakut në Biblën e Shenjtë

“ Alkooli është punë dore e Shejtanit thotë...”

Kur'an-i i Shenjtë

5:93

4. ARABËT DHE ARABIA: NË BIBLËN KRISHTERE –

“Profecia kundër Arabisë...”

Isaiah 21:13

[Vëni re ndryshimin katastrofal të fjalisë

King James Version (ang.) “*The burden upon Arabia...*”

Isaiah 21:13

Përkthimi i versetit në gj. Angleze është diçka me kuptim dhe karakter tjetër :

“*Barra mbi Arabinë...*” do të ishte përkthimi dhe kuptimi i këtyre fjalëve. Fjalët e përkthyer nga gjuhëtarët dhe profesorët shqiptarë nuk kanë kurrfarë kuptimi mbi atë se çka do të ceket më poshtë.]

BARRA (ang. BURDEN): ka kuptimin e përgjegjësisë së Muslimanëve të përhapin FENË ISLAME.

Isaia ka përmendur këtë pasi që ka patur visionin (*parafytyrimin*) e qerreve me gomarë dhe me deve.

Qerret me gomarë del se është Jezusi (p.m.q.t) që ka hyrë në Jerusalem hipur mbi dy gomarë (Mateu 21:7) . Shtrohet pyetja - KUSH ËSHTË AI HIPUR MBI “QERRE ME DEVE” ?

Nuk do të ishte askush tjetër pos Muhammedit (p.m.q.t) që erdhi pas gjashtëqind vjet pas Jezusit (p.m.q.t) . Nëse ky konkluzion nuk pranohet atëherë kjo profeci do të ishte ende e paplotësuar.

“...bashkë me fshatrat në të cilat banojnë ata të KEDARIT

Isaiah 42:11

“Arabia dhe tërë princat e KEDARIT”

Ezekiel 27:21

“The International Standard Bible Encyclopedia” – citon si më poshtë:

PËR FISIN E ISHMAELIT, KEDAR-i DO TË ISHTE GJËJA MË E RËNDËSISHME, DHE NË KËTË MËNYRË MË VONË KY EMËR DO TË VINTE NË APLIKIM NË TËRË Fiset e SHKRETËTIRËS. ËSHTË KJO NËPËRMJET KEDARIT (arab. Keidar) QË GJENELOGJISTËT MUSLIMAN GJËRMUAN PREJARDHJEN E MUHAMEDIT a.s. NGA ISHMAELI

“...u paraqit në madhështinë e tij nga mali Paran, arriti NGA MESI I NJË MORIE SHENJËTORËSH;...”

Ligji i përtërirë 33:2

[Vëni re përsëri përkthimin e këtij verseti nga autorët shqiptarë:

“...he (Muhammad p.b.u.h) shined from mount Paran (in Arabia) and he came WITH TEN THOUSAND SAINTS.” (referring to Mohammad’s conquest of Makkah).

Deuteronomy 33:2

Do të duhej të ishte :

“...U paraqit në madhëshinë e tij nga mali Paran, dhe arriti me DHJETË MIJË SHENJËTORË.”(i përgjigjet Muhammedit p.m.q.t. në pushtimin e Mekës)

Nuk është çudi që ky ndryshim, bastardhim i fjalëve prej një VERSIONI TË VJETËR në një VERSION PAK MË TË RI të pësojnë fjalët, e bile edhe të hiqen, për shkaqe *“arritjes së qartësisë dhe korrektesisë së gjuhës shqipe”*

“...dhe unë [vëni re “U” e madhe dhe “u” e vogël që simbolizon Zotin e Madhërishëm nuk prish aq punë] do t’i bëj ziliqarë (Hebrenjtë) me njerëz (Arabët) që nuk janë një popull. Do të ngacmoj (Hebrenjtë) smirëren e tyre me një komb që s’është në vete.”(Arabët para-Islamik).

Ligji i përtrirë 32:21

5. BAKA ËSHTË MEKA : KIBLA E SHENJTË E NDËRTUAR NGA PROFETI IBRAHIMI (P.M.Q.T) DHE DJALIT TË TIJ ISMAILIT (P.M.Q.T) ËSHTË NË MEKE

Emri Meka është e përmendur në Kur'anin e Shenjtë në 48:24. Emër tjetër për Meken është Bakka, varësisht nga dialektet e fiseve; kjo është gjithashtu e përmendur njëherë në suren Ali Imran 3:96

“ Shtëpia (xhamia) e pare e ndërtuar për njerëz, është ajo që u ngrit në Bekë (Meke), e dobishme, udhërrëfyese për mbarë njerëzimin

Mjaftë çudi, kjo fjalë *Beka* është e përmendur nga profeti David (p.m.q.t) në Bibël:

“Kur kalojnë luginën e Bakas e shëndrrojnë atë NË NJË VEND BURIMESH, dhe shiu i parë e mbulon me bekime.”

Psalm 84:6

“NË NJË VEND BURIMESH” është e mirënjohur Burimi i ujit ZEM-ZEM, që është prezente edhe sot, afër Kibles së Shenjtë;

6. DAVIDI - NJERI I DASHUR NGA ANA E ZOTIT, KRYEN KRIM (TRADHËTI) BASHKËSHORTORE ME BATH-SHEBA, GRUAN E URIAHUT.

“ Davidi dërgoi lajmëtarë për të marrë;(Bath-Shebën) kështu ajo erdhi tek ai dhe ajo ra në shtrat me të (ka patur marrëdhënie), pastaj u pastrua nga papastërtia e saj dhe u kthye në shtëpinë e vet

2 Samuel 11:4

“ Davidi (p.m.q.t) tradhëtisht ka shkaktuar vdekjen e Urah, burrin e Bath-Shebës

2 Samuel 11:6-25

“ Davidi (p.m.q.t) turpshëm vallëzonte LAKURIQ,-shiqo në përmbajtje nën “PROFETË POR LAKURIQ”

7. DERRAT – MISHI I TYRE I NDALUAR

“ Nuk do të hamë nga mishi i tyre (i derrit) dhe nuk do të prekni trupat e tyre të pajetë; për ju janë të papastër”

Levitiku 11:8

Jezusi (p.m.q.t) shkatërroi dy mijë derra për ta shëruar një njeri

“ Dhe Jezusi menjëherë u lejoi atyre; atëherë frymërat e ndyra (demonët) mbasi dolën, hynë në derrat dhe tufa u hodh poshtë nga gremina në det; ishin afërsisht dy mijë krerë, dhe u mbytën në det”

Marku 5:13

8. DJEMT E PERËNDISË – BIBLA CEK DJEMË TË ZOTIT ME TONELATA

“... bir i Emosit, bir i Setit, bir i Adamit, i PERËNDISË”

Lluka 3:38

“DJEMT E PERËNDISË pane që vajzat e njerëzve ishin të bukura dhe morën për grua të gjitha ato që i zgjodhën vetë.”

“Kur BIJTË E PERËNDISË iu afruan bijave të njerëzve dhe këto u lindën atyre fëmijë . Ata janë heronjtë që jetuan në kohët e lashtësisë...”

Zanafilla 6:2-4

“ ... dhe do t'i thuash Faraonit:”Kështu thotë Zoti : Izraeli është BIRI IM, I PARALINDURI IM”

Ekzodi 4:22

“ dhe EFRAIMI është i PARALINDURI IM”

Jeremia 31:9

“Do të shpall dekretin e Zotit. Ai më ka thënë :«Ti je BIRI IM (o Davidi), sot MË LINDE”

Psalmeve 2:7

“ Sepse të gjithë që udhëhiqen nga kjo FRYMA E PERËNDISË janë BIJË TË PERËNDISË”

Romakëve 8:14

9. DHUNIM – VËLLAU DHUNON DHE KRYEN INCEST ME MOTRËN E TIJ –

“ Po ai (Amoni, njëri nga djemtë e Davudit) nuk deshi ta dëgjojë, dhe duke qenë më i fortë se ajo (motra e tij Tamara) e dhunoi dhe ra në shtrat me të”

2 Samuelit 13:14

Djali kryen incest dhe dhunon nënën e tij

“ Ngritën pastaj një çadër dhe mbi taracën për Absalomin, dhe Absalomi HYRI te konkubinat¹ e atit të tij në sytë e tërë Izraelit.

2 Samuelit 16:22

10. ELOHIM - NË HEBRAISHTË FJALË PËR FJALË DON TË THOTË "ZOTËRA".

Kjo fjalë Elohim është përkthyer vazhdimisht si “ZOTËRA” në nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë vende në dhjatën e vjetër. Krishterët sidoqoftë kanë bërë përjashtim kur kur ky term

¹ Konkubinë – grua dhe konkubinë janë terme synonime në Biblën e Shenjtë

përmendet që në fillim në Biblën e Shenjtë. Çudi që e bëjnë këtë *QË NË FILLIM* të kapitullit dhe *QË NË FILLIM* të versetit e të ashtuquajturit Libër i tyre i Zotit :

“ Në fillim perëndia (fjalë për fjalë do të duhej të ishte Perënditë, Zotërat) krijoi qiejtë dhe tokën”

Zanafilla 1:1

11. FJALA E ZOTIT – TË MOS HJEKET AS TË SHTOHET ASNJË FJALË

“Do të kujdeseni të zbatoni në praktikë tërë gjërat, që ju urdhëroj; **NUK DO T’U SHTONI AS DO T’U HIQNI ASGJË”**

Ligji i përtrirë 12:32

12. FRYMA E SHENJTË

Çdo sekt dhe fe e kultit krishterë kërkojnë *“Dhuratën”* e SHPIRTIT TË SHENJTË. Kjo dhuratë është aq e lirë sa që 75 00 000 krishterë *“TË RILINDUR”* amerikan gjithashtu lavdërohen me këtë pasuri.

“... dhe do të jetë i përplot me FRYMËN E SHENJTË që në barkun e s’ëmës

Lluka 1:15

Nuk jam ende i aftë që të kuptoj dhe themelojë se çka don të të thotë në të vërtetë kjo frazë “... që në barkun e s’ëmës...”

Medet, i gjori Jezusi (p.m.q.t) është dashur të shënonte kohën për TRIDHJETË VJET pas lindjes së tij të “fitojë” dhuratën e tij FRYMËN E SHENJTË në pagëzimin e tij në duart e GJONIT TË PAGËZUAR (Mateu 3:16).

“... dhe Elizabeta u mbush me Frymën e Shenjtë.”

Lluka 1:41

“...dhe Zakaria, ati i tij, u mbush me Frymën e Shenjtë.”

Lluka 1:67

“Dhe, si tha këto fjalë (Jezusi (p.m.q.t))HUKATI MBI TA DHE THA:«MERRNI FRYMËN E SHENJTË».

Gjoni 20:22

“Po atë që do të blasfemojë kundër FRYMËS SË SHENJTË nuk do të ketë fjalë përjetë; ai është fajtor për denim të përjetshëm”.

Marku 3:29

13. GRATË – NDALOHEN TA HAPIN GOJËN E TYRE NË KISHË

“Gratë tuaj të HESHTIN në kishë, sepse nuk u lejohet të flasin...”

1 Korintasve 14:34-35

“asaj do t`i pritet dora (për shpëtuarjen e jetës së burrit të saj)”

Ligji i përtrirë 25:11-12

“Burri të SUNDOJË MBI GRUAN

Zanafilla 3:16

“Kreu i gruas është BURRI

Korintasve 11:3

“Njeriu mund ta SHES vajzën e tij

Ekzodi 21:7

Kurse krishterët janë ata të cilët flasin më së shumti për të drejtat e gruas dhe njeriut

14. GJENELOGJIA E JEZUIT

Krishterët kanë rregulluar dy lista të ndara për stërgjiyshërit e Jezusit (p.m.q.t); a) Mateu 1:1-16 dhe b) Llukës 3:23-38. Në këto dy lista që përmbajnë gjashtëdhjetë e gjashtë emra, gjendet vetëm një emër që është në të dy listat dhe ai është Zdukthëtari Jozefi, dhe ai kurrë nuk do duhej të përmendej pasi që ai nuk ishte përgjegjës për kuptimin (interpretimin) e Jezuit (p.m.q.t)

15. INCEST –

“Marëdhënie seksuale në mes dy personave që ka lidhje gjaku”, (New Collins Dictionary). Për shembull në mes babait dhe vajzës, djalit dhe nënës, motër dhe vëlla etj.

INCEST NË LIBRIN E ZOTIT (?) mes babait dhe vajzave

“Kështu po atë natë, (bijat e Lotit) dhanë verë babait të tyre (Lotit) dhe e madhja U SHTRI bashkë me të atim, ...”

“Të nesërmen vajza më e madhe i tha më të voglës:«Ja, natën e kaluar unë RASHË NË SHTRAT (marëdhënie seksuale) bashkë me babain tim; le të bëjmë që ai të pijë verë edhe sonte; pastaj ti futu dhe SHTRIU me të që të mund ti sigurojmë pasardhës babait tonë”.

“Edhe atë natë i dhanë verë babait të tyre dhe më e vogla shkoi të SHTRIHET bashkë me të ...”

“Kështu dy bijat e Lotit u NGJIZËN nga BABAI I TYRE

Zanafilla 19:33-35

Në versionet më të vjetra si ajo e King James-it dhe Roman Catholic Version, “*Marëdhënie*” është e përshkruar turbullt si “*ngjizet nga babai i tyre*”.

Incest në mes nënës dhe djalit:

“Dhe ndodhi që, ndërsa Izraeli (Jakobi) banonte në atë atë vend, Reubeni (djali i tij i madh) shkoi e RA NË SHTRAT me Bilbah, konkubinën e atit të tij”

Zanafilla 35:22

Incest në mes vjerrit dhe nuses së djalit të tij :

“Sa e pa (Tamaren,nusen e djalit të tij), Juda mendoi që ajo ishte prostitutë, sepse e kishte fytyrën të mbuluar”.

“Prandaj ai iu afrua asaj në rrugë dhe i tha : «LËRMË TË HYJ TE TI»... Ajo iu përgjegj : «Çfarë do të më japësh për të HYRË tek unë ?»

“Atëherë ai tha: «Do të të dërgoj një keç nga kopeja ime». Ajo e pyeti :«A më jep një peng derisa të ma dërgosh?»”

“Ai i tha :«Çfarë pengu duhet të të jap?» Ajo u përgjegj: «Vulën tënde, kordonin tënd dhe bastunin që ke në dorë». Ai ia dha, dhe HYRI te ajo dhe ajo u NGJIZ me të.”

Zanafilla 38:15-18

Gjatë kësaj marëdhënie incestuoze në mes vjerrit dhe nuses, kanë lindur bineqë, të cilët janë përcaktuar të jenë stërgjyshërit e lashtë e Jezu Krishtit. Shiqo Mateu 1:3

“Judës i lindi nga Tamara Faresi dhe Zara...”

Incest dhe përdhunim në mes vëllaut dhe motrës :

(ç) “Atëherë Amoni i tha Tamarës (Tamara, motra e tij, të mos jetë konfuzë me Tamarën në “(c)” më lartë)...

“... dhe ai i tha :«Eja shtriu me mua, motra ime».

“Ajo iu përgjegj ;«Jo vëllai im (Amnoni, njëri nga djemtë e Davidid, njeriut të dashur të Zotit), mos më poshtro
kështu;...”

“... Po ai nuk deshi të dëgjojë duke qenë më i fortë se ajo, e dhunoi dhe ra në shtrat me të (me motrën e tij).”

2 Samuelit 13:10-14

Përdhunime me shumicë dhe Incest në mes djalit dhe nënës

“Ngritën pastaj një çadër mbi taracën për Absalomin (djalin tjetër të Mbretit Davidi (p.m.q.t)), dhe Absalomi hyri te konkubinat e atit të tij në sytë e tërë Izraelit.

2 Samuelit 16:22

“Në sytë e tërë Izraelit...” – Kjo, si përmbushje e premtimit të Perëndisë për mbretin Davidi :

“Kështu thotë Zoti:«Ja, unë do të sjellë kundrejt teje (Davidit) fatkeqësinë nga VETË SHTËPIA JOTE (djalin e Davidit, Absalomin) dhe do t'i marrë gratë e tua para syve të tu për t'ia dhënë një tjetri (djalit të tij), që do të bashkohet me to ditën.(të ketë marrëdhënie seksuale me to). “

“Sepse ti e ke bërë këtë gjë fshehurazi (me Bath – Shebën gruan e Uriahut); kurse unë do ta bëjë përpara tërë Izraelit në DRITËN E DIELLIT.”

2 Samuelit 12:11-12

Çfarë loje dhe roli po luajnë profetët në Bibël. A nuk duhet që ata të jenë të dërguar për ta drejtuar dhe mësuar njerëzimin se ekziston vetëm Një Zot, dhe të bëjnë vepra të mira etj., në vend që të tregojnë amoralitete dhe gjëra më të ndyra që ndodhin në faqen e dheut.

Nuk është çudi se ku e kanë marrë inspirimin revistat “Penthouse”, “Playboy” dhe “Erosi” . Prej ku tjetër pos “Librit të Librave (Biblën e Shenjtë)”

Për tipe tjera të INCEST-it shiqo Levitiku 18:8-18, 20:11-14 dhe 17-21.

16. ISHMAELI APO ISAKU? :

Kundërshtimet janë tërëbuar në mes njerëzve të biblës dhe Shtëpisë së Islamit se cili prej djemve të Abrahamit (p.m.q.t), Ishmaeli apo Isaku ishte propozuar për flijim .

Bibla është mjaft e qartë në disajniin e propozimit :

“Dhe perëndia tha :«Merr tani birin tënd,birin tënd TË VETËM, atë që ti do, ISAKUN, shko në vendin e Moriahve dhe sakrifikoje në një nga malet që do të të tregoj”

Zanafilla 22:2

Nëse në çdo moment, një pasardhës i Abrahamit (p.m.q.t) mund të përshkruhet si *“birin tënd të vetëm”* ai do të ishte vetëm Ishmaeli (p.m.q.t), sepse më shumë se trembëdhjetë vite, ai ishte djali dhe fara e vetme e Abrahamit!

Lapsi falls i shkruesve ishte në duart e Izraelitëve të cilët i botuan Librat e Moisiut (p.m.q.t), ku edhe profeti Jeremia ankohet (qan):

“Si mund të thoni:”Ne jemi të urtë dhe ligji i Zotit është me ne”?Po ja, PENA e rreme e shkruesve e ka bërë një FALSITET”

Jeremiah 8:8

Kur çiftutët janë gjetur të kthejnë një Israelit në një Ishmaelit, ku nuk çfaqet asnjë motiv, atëherë sa lehtë për ta të ndërrojnë fjalën *“birin tënd të vetëm Ishmaelin”* në *“birin tënd të vetëm Isakun”!*

Forco këto sëmundje të Israelitëve në Biblën tënde :

“...AMASAN ishte bir i një burri të quajtur Jithra IZRAELITI”

2 Samuelit 17:25

Kundërshtohet me

“Abigaili lindi AMASAN, atë i të cilit ishte Jetheri (njësoj si ajo Jithra) ISHMAELITI.

1 Kronikave 2:17

17. HEBRENJTË – POPULL RREBEL

“U bëtë rebelë kundër Zotit, qysh nga dita që ju kam njohur.”

Ligji i përtrirë 9:24

Popull qafë – fortë :

“Sepse unë e njoh frymën tënde rebele dhe fortësinë e qafës sate. Ja, sot kur akoma jam gjallë midis jush, ju u bëtë rebelë kundër Zotit: aq më tepër do të bëheni mbas vdekjes sime.”

Ligji i përtrirë 31:27

Skllavëria e dytë në Egjipt :

“Dhe Zoti do të të kthejë në Egjipt (Izraelitët) me anije, nëpër rrugën që pata thënë: “Nuk do ta shohësh më kurrë!”. Dhe aty do tju ofrojnë armiqëve tuaj për t`ju shitur si skllavë dhe si skllave, por ASKUSH nuk do tju blejë.”

Ligji i përtrirë 28:68

“... tani ai (Zoti) do të kuptojë paudhësinë e tyre dhe do të ndëshkojë mëkatet e tyre (Hebrenjëve): ata do të KTHEHEN në Egjipt (për robërim të dytë)”

Osea 8:13

Hebrenjtë të ndërrohen:

“Prandaj unë (Jezusi (p.m.q.t)) po ju them se juve (Hebrenjëve) do t`ju hiqet mbretëria e Perëndisë dhe do t`i jepet një kombi që do ta bëjë të japë frut

Mateu 21:43

18. JEHOVAH :

Është një fakt i çuditshëm, që nëse Jehovah është emër i Zotit ashtu siç Dëshmitarët e Jehovahit aq guximshëm deklarojnë, atëherë kjo fjalë me zërim të lartë nuk ndodhet asnjëherë në dorëshkrimet origjinale prej njëzetë e shtatë librave të Dhjatës së Re.

Për detale të mëtutjeshme fito një kopje falas të librit tim “Si është Emri i Tij?” (What is His Name?) nga IPCI

19. JEREMIAH – PROFET I CAKTUAR PARA LINDJES SË TIJ

“Para se unë (vini re “u” e vogël për Zotin) të të formoja në barkun e nënës sate, të kam njohur; para se ti të dilje nga babai i saj, të kam shenjtëruar dhe të kam caktuar profet të kombeve”

Jeremia 1:5

Jeremia i mashtruar nga Zoti (?)

“Ti më ke BINDUR, o Zot, dhe unë e lash veten të BINDEM ; ti je më i fortë se unë dhe fitove. Jam bërë objekt talljesh çdo ditë; kushdo tallet me mua

Jeremia 20:7

[“O Lord, thou hast DECEIVED me, and I was DECEIVED:...”

Jeremiah 20:7

Në gj. Angleze (KJV) fjala “*bindur*” nuk ka fare ngjajshmëri me fjalën “*Deceive*” e që në përkthim do të thotë “*i mashtruar*”. Për më shumë hollësira shiko fjalorin Anglisht – Shqip.]

20. JERUZALEMI – PROSTITUTË E PANGOPUR –

Ende e pakënaqur, je KURVËRUAR me Asirianët; po, je KURVËRUAR me ata, por PA QENË E KËNAQUR”

Ezekiel 16:28

Kurvëria e dy motrave – oholahut dhe oholibahut

“Dhe ajo vazhdoi EPSHET me stilin e konkubinave që i takon atyre që epshi i tyre (gjenitalet) është si e asaj të gomaricës dhe ORGANEVE GJENITALE të tyre si ato të kuajve

Ezekiel 23:1-49 (New World Translation)

“... sepse fryma e prostitucionit i devijon (ata, Izraelitët), dhe ata kurvërohen, duke u shmangur nga Perëndia i tyre.”

Osea 4:12, 6:10 dhe 9:1

21. JEZUSI (P.M.Q.T) : MRREKULLIA E PARË E TIJ NË BIBLËN E SHENJTË DHE NË KUR`AN-IN E SHENJTË:

Shëndrrimi i ujit në VERË në dasmën e Kanas

Gjoni 2:9

Në KUR`AN-in e Shenjtë Mrrekullia e tij e parë ishte që ta mbronte nënën e tij, si foshnje, kundër akuzave të pavërteta të kundërshtarëve të tij.

Suretu Merjem 19:30-33

Fjalët e tija (Jezusit) fyese ndaj njerëzve më të vjetër :

(a) “...O skribë dhe farisenj hipokritël!” Mateu 23:13, 23:27

(b) “O gjarpërinjë, o pjellë nëpërkash!...” Mateu 23:23

(c) “Ky brez i mbrapshtë dhe kurorëshkelës!...” Mateu 12:39

Çfarë shembulli të mirë po na jep Jezusi (p.m.q.t) në Biblën e Shenjtë për rrespektimin e më të vjetërve (!).

Ai e thërret nënën e tij “O GRUA” Gjoni 2:4, në të njëjtën mënyrë të cilës iu drejtohej edhe PROSTITUTËS.

“... O GRUA ku janë ata që paditnin?”

Gjoni 8:10

“*PRINCI I PAQES*” mburret me atë se nuk ka ardhur të vejë paqe në tokë por zjarr dhe përçarje!

“Unë erdha të hedh zjarr mbi tokë dhe sa dëshiroj që ai të ishte tashmë i ndezur ...

A kuptoni se erdha të sjell paqe mbi tokë? Jo, po ju them, por më shumë përçarje “

Lluka 12:49 dhe 51

Jezusi (p.m.q.t) s`është Zot! – Jezusi (p.m.q.t) nuk ka lejuar ta thërrasin “*i mirë*”, e kursesi Zot, e lere më me “z” të vogël.

“Dhe ja, iu afrua dikush dhe tha:«Mësues i mirë, çfarë të mire duhej të bëj që të jetë të përhershme?»».

“Dhe ai (Jezusi (p.m.q.t)) tha:«PSE MË QUAN TË MIRË? Askush nuk është i mirë, përveç një të vetmit: PERËNDIA»...”

Mateu 19:16-17

Jezusi (p.m.q.t) – fuqia jo e vetme e tij:

“Pastaj Jezusi u afrua dhe u foli atyre duke thënë: «Mua MË ËSHTË DHËNË çdo pushtet në qiell e në tokë»

Mateu 28:18

“Unë s`mund të BËJ ASGJË nga vetja ime; gjykoj sipas asaj që dëgjoj dhe gjyqi im është i drejtë, sepse nuk kërkoj vullnetin tim, por vullnetin e ATIJ QË MË KA D Ë R G U A R”

Gjoni 5:30

“Por nëse unë i dëboj demonët me GISHTIN E PERËNDISË...”

Lluka 11:20

“Atëherë ata e hoqën gurin prej vendit ku ishte shtrirë i vdekuri. Dhe Jezusi i ngriti sytë lartë dhe tha:«O ATË të falënderoj QË MË KE DËRGUAR (d.m.th. Zoti e ka dërguar Zotin apo...!?)”

“Unë e dija mirë se TI GJITHNJË MË DËGJON, por i kam thënë këto për turmën që është përreth, që të besojnë se TI MË KE DËRGUAR.”

“Dhe , mbasi tha këto, thirri me zë të lartë:«Llazar, eja jashtë!”

“Atëherë i vdekuri doli...”

Gjoni 11:41-43

Atëherë kush i dha prap jetë Llazarit? Përgjegja është “Zoti”, se Zoti dëgjon lutjet e Jezusit si gjithmonë!

Dhe mbas të gjitha këtyre fakteve Krishterëve nuk u është e mjaftueshme që të besojnë se ai është i dërguar i Zotit, e jo Zot!

Dëgjoni tash dëshmitë e Piterit :

“Burra të Izraelit, e dëgjoni këtë fjalë: Jezusi Nazareas NJERIU i dëftuar nga PERËNDIA (d.m.th. profet) ndër ju me vepra të fuqishme, me mrekulli dhe shenja që Perëndia bëri ndër ju ME ANË TË TIJ, siç edhe vet e dini.”

Veprat e Apostujve 2:22

A ishte Lluka i inspiruar nga Perëndia të thoshte se Jezusi (p.m.q.t) ishte djali i Jozefit ?

“Dhe Jezusi ishte RRETH (“rreth” ! sikur të mos ta dinte Fryma e Shenjtë se sa vjeç i kishte) tridhjetë vjeç ; dhe e pandehnin se ishte biri i Jozefit ...”

Lluka 3 23

Fjalët ”e *pandehnin se* “ duhej të viheshin në kllapa sa i përket përkthimit. Në fakt ajo nuk ndodhet në dorëshkrimin original Grek të Llukës ! Këto fjalë janë vetëm llustër e përkthyesve.

Gjykoni vetë :

“And Jezus himself began to be ABOUT thirty years of age, being (AS WAS SUPPOSED) the son of Jozeph...”

Luke 3:23

Në gjuhë të tjera të botës, si Arabe, Afrikane, Zulu, Shqipe etj. Fjalët “e *pandehnin se*” kanë mbetur në përkthim por kllapat janë hequr. Kështu gjatë largimit të kllapave fjalët janë shëndrruar në deklaratë të Llukës, dhe nëse Lluka ishte i inspiruar atëherë fjalët janë tejsheshtur në shqiptimin e Perëndisë. Kjo është se sa lehtë fjala e njeriut është transformuar në fjalë të Zotit në Krishterizëm.

Jezusi (p.m.q.t) në vet – kujdesje:

“...iu afrua një grua me një alabastër me vaj të parfymuar shumë të kushtueshëm, dhe ia derdhi mbi kokën e tij, kur ai po rrinte në tryezë.”

“Kur e panë këtë gjë DISHEPUJT e tij U ZEMËRUAN DHE THANË:«PSE GJITHË KY SHPENZIM I KOTË?»”

“Ky vaj, në fakt, mund të shitej shumë shtrenjtë dhe paratë t’u jepeshin të varfërve.”

“Por Jezusi e mori vesh dhe u tha atyre:«Pse e shqetësoni këtë grua? Ajo kreu në fakt një vepër të mirë ndaj meje.

“Sepse të VARFËRIT DO T’I KENI PËRHERË ME JU, por mua nuk do të më kenit përherë...”

Mateu 26:7-11

Të gjorët dishepujt, u munduan të bëjnë vepër të mirë por “Zoti” i tyre nuk i lejoi sepse atij i vinte mirë të parfymosej.

22. JEZUSI (P.M.Q.T) “PERËNDI”? I PAFUQISHËM !:

“Unë S’MUND TË BËJË ASGJË nga vetja ime...”

Gjoni 5:30

AI NUK KA DITUR ASGJË PËR DITËN E FUNDIT (Kiametit)

“Sa për atë ditë dhe atë orë, askush nuk e di, as engjëjt në qiell, AS BIRI, por vetëm ATË .”

Marku 13:32

AI ISHTE INJORANT I STINËVE :

“dhe duke parë nga larg një fik që kishte gjethe, shkoi për të parë nëse mund të gjente diçka atje; por, kur iu afrua, s'gjeti asgjë përveç gjetheve, sepse NUK ISHTE KOHA E FIQVE.

“Atëherë Jezusi (p.m.q.t), duke iu drejtuar fikut tha:« Askush mos ngrëntë kurrë fryt prej teje përjetë»...”

Marku 11:13

Jezusi (p.m.q.t) Perëndi i etshëm ?!

(d) “(Jezusi) tha :«KAM ETJE!» Gjoni 19:28

Jezusi (p.m.q.t) “Perëndi” që qan ?!

(e) “*Jezusi QAU*” Gjoni 11 35

Vëni re : kjo është fjalia më e shkurtër në Bibël (vetëm dy fjalë).

MERRENI ME MEND “PERËNDIA” I TUNDUAR NGA DEMONI

“dhe qëndroi (Jezusi) në shkretëtirë dyzet ditë i tunduar nga Satanai”.

Marku 1:13

23. JEZUSI (P.M.Q.T) (RACIST) – I DËRGUAR VETËM PËR HEBRENJTË !

“Këto janë të dymbëdhjetët që Jezusi i dërgoi mbasi u dha këto urdhëra:«Mos shkoni ndër paganë dhe mos hyni në ASNJË qytet të Samaritanëve.”

“por shkoni më mirë te delet e humbura të SHTËPISË SË IZRAELIT(vetëm te Izraelët)

“Por ai (Jezusi) u përgjigj dhe tha:«Unë nuk jam dërguar gjetiu, përveç te delet e humbura të SHTËPISË SË IZRAELIT (Hebrenjtë)

“Por ajo (gruaja kananase) erdhi dhe e adhuroi, duke thënë:«O Zot, ndihmomë!».

“Ai u përgjigj, duke thënë:«Nuk është gjë e mirë të marrësh bukën e fëmijëve dhe t`ua hedhësh KËLYSHËVE TË QENVE (Johebrejasve).”

Mateu 15:24-26

24.JEZUSI (P.M.Q.T) – LAJME INTERESANTE

JEZUSI ARRITJA E DYTË KURRË E REALIZUAR

“Por kur do t`ju përndjehin në një qytet, ikni në një tjetër sepse NË TË VËRTETË ju them se nuk do të përshkuari qytetet e Izraelit, para se të VIJË BIRI I NJERIUT (bën fjalë për vehten)

Mateu 10:23

Dishepujt e Jezusit shpëtuan, dhe shpëtuan, dhe shpëtuan, dhe tash mbaruan dymijë vjet, pa asnjë shenjë të kthimit të Jezuit

Jezusi (p.m.q.t) ka folur me shëmbëlltyra të mashtrojë të pabesueshmen

“...Dhe ai u tha atyre:«Juve u është dhenë të njihni misterin e mbretërisë së Perëndisë; kurse atyre që janë përjashta të gjitha u jepen me shëmbëlltyra.»

“që:Duke parë, të shohin, por të MOS vën re;edhe duke dëgjuar, të dëgjojnë, por të MOS kuptojnë, se mos pendohen dhe mëkatet u falen”»

Marku 4:11-12

Urrejtja si themeluese e besimit të tij (Jezusit).

“Nëse ndokush vjen tek unë dhe NUK URREN babanë e vet dhe nënën e vet, gruan dhe fëmijët, vëllezërit dhe motrat, madje edhe jetën e vet NUK MUND TË JETË dishepulli im.

Lluka 14:26

Pjetri kundërshton Jezusin në lidhje me vetveten si “udha e vetme”.

“Jezusi (p.m.q.t) tha:«Unë jam udha, e vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati përveç se nëpërmjet meje”

Gjoni 14:6

KUNDËSHTOHET ME :

“Atëherë Pjetri hapi gojën...Por në ÇFARËDO KOMBI, ai që ka frikë prej tij dhe që vepron drejtësisht, ËSHTË I PRANUAR NGA AI (Zoti)

Veprat e Apostujve 10:34-35

25. KETURAH : GRUAJA E TRETË E ABRAHAMIT

“Pastaj Abrahami mori një grua tjetër, që quhej Keturah.

Zanafilla 25:1

Keturah si grua e Abrahamit kundërshtohet me vet fjalën “*Fjalë e Perëndisë*” psh. 1Kronikave 1:32 ku Keturah përshkruhet si KONKUBINË e Abrahamit. Kjo është një ekstra kontradiktë në Bibël, në të kundërtën “*Grua*” dhe “*Konkubinë*” janë terme sinonime (të njëjta).

26. KOPII – KJO FJALË NË BIBËL PËRDORËT VETËM TRE HERË.

“Një KOPII nuk do të hyjë në asamblenë e Zotit...”

Ligji i Përrirë 23:2

“Një popull BASTARD (kopil) po të banojë në....”

Zakaria 8:9

“Por po të mbetemi të pandrequr, kur të gjithë u bënë pjestarë, atëherë janë KOPILA dhe jo bij!”

Hebrenjëve 12:8

27. KUNDËRSHTIMET – NË BIBËL

“Zoti “ e nxiti Davidin të regjistronte popullin e Izraelit (2 Samuelit 24:1) apo SATANA e nxiti atë (1 Kronikave 21:1)

Davidi vrau 700 qerrq me 40 000 kalorës (2 Samuelit 10:18) apo Davidi (p.m.q.t) vrau 7000 kalorës dhe 40 000 këmbësorë (1 Kronikave 19:18)

700 apo 7000 dhe kalorës apo këmbësorë

Solomoni kishte 2000 bate(banjo) apo 3000 bate ?

1Mbretërve 7:26 vs 2 Kronikave 4:5

Solomoni kishte 4000 stalla kuajsh apo 40 000 ?

2 Kronikave 9:25 vs 1 Mbretërve 4:26

A i dha Zoti KËSHILLA Saulit apo jo ?

1 Samuelit 28:6 vs 1 Kronikave 10:13-14

“Askush nuk u ngjit në qiell...”

Gjoni 3:13

Kundërshtohet me

“...dhe e Elia u ngjit në qiell ...”

2 Mbretërve 2:11

“Pra Enoku eci me perëndinë, por nuk e gjend më,
sepse Perëndia e mori me vete”

Zanafilla 5:24

Jezusi nuk ka humbur ASNJË dishepull apo ai e humbi VETËM NJË

Gjoni 18:9 vs Gjoni 17:12

(h) TË GJITHË janë mëkatarë 2 Kronikave 6:36

Kundërshtim me

Kush lind nga perëndia NUK KRYEN MËKATE

1 Gjon 3:9

28. KURVËRIA – SHIKO NËN “JERUZALEMI” NË PËRMBAJTJE

29. MASAKËR – NË DUART E HEBRENJËVE

“Prandaj VRISNI çdo mashkull nga fëmijë dhe VRISNI çdo grua që ka marëdhënie seksuale me një burrë.”

“Por ruajini të GJALLA për vete të gjitha VAJZAT që nuk kanë pasur marëdhënie seksuale me burrat

Numrat 31:17-18

Dhe Hebrenjtë ruajtën për vete vetëm 32 000 vajza virgjine, versetet 31:35 dhe 31:40

“Por nga qytetet e këtyre popujve që Zoti, Perëndia yt, të jep si trashëgim, nuk ke për të lënë ASGJË QË MERR FRYMË;

Ligji i përtrirë 20:16

“Dhe (Hebrenjtë) shfatosën gjithçka kishte në qytet, duke vrarë me shpatë burra e gra, fëmijë dhe pleq e madje qe, dele dhe gomarë. (as gomarët nuk janë kursyer !)

Jozeut 6:21

“Nuk la (Jozeu) ASNJË të gjallë!...”

Jozeut 10:28

30. MELKISEDEKU – KY PRIFT I LARTË I SALEMIT KA KUALITETE QË E MBISHËNDRRISIN JEZUS KRISHTIN (P.M.Q.T):

“Pa atë, pa nënë, pa gjeneologji, pa pasur as fillim ditësh as fund jete,...” (prifti i shumë të Lartit Perëndi-Melkisedeku)

Hebrenjëve 7:3

(Këto attribute i takojnë vetëm All-llahut të Madhërishëm, por ky prift po del se edhe ky është njëfarë ”Zoti”)

31. MESSIAH : PËRKTHYER “KRISHT”!

Mesia është emër shumë i shpeshtë në Hebreizëm. Përkthyer në greqishte ajo shëndrrohet në “*Kristos*” (ang. Christos), që në gjuhën shqipe don të thotë “*Vajosur*”. Fjala “*Vajosur*” çdokund çfaqet në përkthimin anglisht të Biblës (cilido version) e që në gj. Hebre në mënyrë konstante është fjala “*Messiah*”.Sot Krishterët krenohen më Jezusin se vetëm ai është “*Krish*” (Messiah) duke mos e ditur kuptimin e kësaj fjale.

Këtu janë disa shembuj të gatshëm :

“Unë jam Perëndia i Bethelit, ku ti ke VAJOSUR (messiah) një PËRMENDORË ”(Përmendore të Krishtit !)

Zanafilla 31:13

“Pastaj Moisiu mori VAJIN (messiah) e vajosjes, vajosi tabernakullin (vajin e Krishtit dhe tabernakullin e Krishtit !?)

Levitiku 8:10

“... do ti japë (Zoti) forcë mbretit të tij dhe do ta lartojë FORCËN e të VAJOSURITt të tij (messiah)...” (forcën e Krishtit !?)

1 Samuelit 2:10

“ Ti ishe një kerubin i VAJOSUR (messiah)...” (kerubini Krishti !?)

Ezekiel 28:14

“kështu i thotë Zoti TË VAJOSURIT (messiah) të tij , Kirit...” (Krisht Kiri – po duket paksa qesharake por tash i zbuluam dy Krishta)

Isaia 45:1

(Zoti i drejtohet edhe mbretit si Messiah i Tij!)

32. MËKATI I PARË (ORIGINAL SIN) –

Dogma Krishtere që thotë se mëkati që është i trashëguar është kundër të gjitha etikave, moralit dhe kuptimit të ngushtë. Ajo është kundër thënies së vërtetë të Zotit:

“ Shpirti që mëkaton do të vdesë, i biri (stërnipat e Adamit) nuk do të mbartë paudhësinë a atit (Adamit) dhe ati nuk do të mbartë paudhësinë e të birit; drejtësia e të drejtut do të jetë mbi të; pabesia e pabesit do të bien mbi të

Në rast se i pabesi largohet nga të gjitha mëkatet që kryente, në rast se rrespekton të gjitha statutet e mija dhe zbaton barazinë dhe drejtësinë, ai me siguri ka për të jetuar; **NUK KA PËR TË VDEKUR**

Ezekiel 18:20-21

(a) NË ISLAM NOCIONI I MËKATIT TË PARË VËSHTROHET SI PAPAJTUESHMËRI ME DREJTËSINË E ALL-LLAH-UT (xh.n.). SI MUNDET QË ZOTI I DREJTËSISË DHE I MËSHIRËS TË BËJË TË PËRGJEGJSHËM NJË FËMIJË TË PAFAJSHËM, APO SË PAKU TA FAJSOJË PËR MËKATET E STËRGJYSHIT TË PARË ? (Steve a. Johnson)

(b) ASNJË FIS PA FE NUK KA PARAFYTYRUAR NJË IDE AQ TË SHËMTUAR, KONSIDERUAR SE AJO KA BËRË ASUMPCION, QË NJERIU KISHTE LINDUR ME NJOLLË TË TRASHËGUAR MBI TË, DHE KJO NJOLLË PËR TË CILIN AI NUK ISHTE PERSONALISHT I PËRGJEGJSHËM PËR KËTË , TË SHPËRBLEHET ME KËTË DHE QË KRIJUESI I TË GJITHA GJËRAVE ËSHTË DASHUR TA SAKRIFIKOJË “DJALIN E

TIJ TË VETËM” TË NEUTRALIZOJË KËTË MISTERIE TË MALLKUEME. (Major Yeats Brown)

Jezusi (p.m.q.t) vet ka vështruar fëmijët si të pafajshëm dhe të pastër, dhe jo të lindur me mëkat, është qartë e thënë në thënien e tij :

“I lini fëmijët e vegjël të vijnë tek unë dhe mos i pengoni, sepse e atyre është mbretëria e Perëndisë.

Marku 10:14

33. MOHIMI – “...MOS IU NËNSHTRO ATIJ DHE MOS DËGJO (MOHO), SYRI YT NUK DUHET TË KETË MËSHIRË PËR KËTË, MOS E KURSE, MOS E FSHEH.”

“ Por ti duhet ta VRASËSH dora jote të jetë e para që të ngrihet kundër tij, për ta vvarë...”

Ligji i përtrirë 13:8-9

34. MUHAMMEDI (P.M.Q.T) – ËSHTË PROFET I VËRTETË SA I TAKON BIBLËS

“...Çdo frymë (çdo profet) që rrëfen se Jezu Krishti ka ardhur në mish, është nga Perëndia.”

1 Gjon 4:2

Krahasuar me Kur`an-nin e Shenjtë 3:45 dhe shumë shënime të Kur`an-it ku Jezui (p.m.q.t) ceket si Krisht.

Muhammedi (p.m.q.t) – përmendet me emër në Bibël :

“Goja e tij është vet ëmbëlsia; por ai është TËRHEQËS NË ÇDO PIKPAMJE (në gj. Hebraike MUHAMMEDIM) Ku është i dashuri im, ky është miku im o bija të Jeruzalemit”

Kantiku i Kantikëve 5:16

Prej dorëshkrimeve origjinale Hebraike fjala “MUHAMMEDIM është përkthyer si *“tërheqës në çdo pikpamje”* ku aktualisht është fjala për Muhammedin a.s me IM si prapashtesë. Prapashtesa IM është shumësi i emrit si rrespekt në gjuhën Hebraike.

Muhammedi (p.m.q.t) “ngushëllues sikur Jezusi (p.m.q.t) :

“Dhe unë do t`i lutem Atit dhe ai do t`ju japë një NGUSHËLLUES TJETËR që do të qëndrojnë PËRGJITHMONË ME JU”

Gjon 14:16

Jezusi (p.m.q.t) ishte “ngushëlluesi” i parë, ndonjë tjetër do të duhej të ishte sikur ai, në çdo pikpamje sikur Jezusi , njeri e jo shpirt (sikur që pohojnë Krishterët për Shpirtin e Shenjtë).

35.ONANIZËM – “TËRHEQJE E PENISIT NGA VAGINA PARA EJAKULIMIT” (THE NEW COLLINS DICTIONARY). TERMI MJEKSOR – “COITUS INTERRUPTUS”. :

“Atëherë juda i tha Onanit :«Shko te gruaja e vëllait tënd, MARTOHU ME TË [Fjala “martohu me të” në gj. Angleze KJV është “go and SLEEP (have sex) with ...] dhe krijoi trashëgimtarë vëllait...”

“Por Onani, duke ditur se këta pasardhës nuk kishin për të qenë të vetët, kur BASHKOHEJ me gruan e të vëllait, (Tamarën), e hidhte farën e tij përtokë për të mos i dhënë pasardhës vëllait të tij.

Zanafilla 38:8-9

George Bernard Shaw, mendimtari dhe filozofi më i madh Britanez për Biblën e Shenjtë thotë : «LIBRI MË I RREZIKSHËM NË BOTË. MBANE MBYLLUR ME ÇELËS, FËMIJA JUAJ NUK DUHET TË KETË KONTAKT ME TË».

36. PALI : NË PREZENCË TË TIJ BËHET DINAK, PËRDORË GËNJESHTRA :

“Ashtu qoftë! Unë nuk u bëra barrë për ju; megjithatë, duke qenë dinak, JU ZURA ME DREDHI.”

2 Korintasve 12:16

Të shkretit Krishterë, çfarë njeriu dinak dhe përtac paska frymëzuar Perëndia për shkruarjen e Librit të Shenjtë)

[Pali ishte prifti më i lartë me personalitet në botën Krishtere. Ai shkroi pjesën më të madhe të Biblës për jetën e Jezu Krishtit, pa u takuar fare me të. Ai në fillim ishte përgjegjësi dhe ekzekutori më i madh për mbytjen e Krishterëve në atë kohë. Mirëpo papritmas duke kalëruar (KJV – Bible Dictionary preface under “P”) pa vizionin e Jezu Krishtit dhe ai ndërroi 360⁰ dhe që nga ai moment filloi ta shkruaj Librin e Librave.(Më gjerësisht në KJV).]

37. PERËNDIA – PERËNDI ME KUALITETE TË PAHIJSHME –

(a) *Zoti që FISHKËLLON (?)* Isaia 5:26, 7:18. Zakaria 10:8

(b) *Zoti që ULËRON (?)* Isaia 42:13, Jeremiah 25:30

(c) Zoti BERBER (?) Isaia 7:20

(ç) Zoti PENDIMTAR (?) Jeremia 15:6, Zanafilla 6:6

(d) Zoti KALËRON mbi një kerubin (?) 2 Samuelit 22:11

(dh) Zoti që VRAU 50 070 njerëz (?) 1 Samuelit 6:19

[Shikoni vetëm çfarë përkthimi katastrofal bënë gjuhëtarët, profesorët dhe besimtarët e të krishterë shqiptarë :

“And he (God) smote the men of Beth – Shemesh, ... even he smote of the people FIFTY THOUSAND AND THREE SCORES AND TEN MEN (50 070) and...”

Holy Bible (KJV) – 1 Samuel 6:19

VS

“Zoti goditi disa njerëz të Beth – Shemeshit, ...ai goditi SHTATËDHJETË NJERËZ të popullit...”

1 Samuelit 6:19

[dallimi në mes 50 070 njerëz dhe 70 është vetëm 50 000]

38. PERËNDIA – ATRIBUTET E TIJ QË KUNDËRSHTOHEN NË MES VETE :

(a) “Askush se ka parë Perëndinë KURRË;..” Gjoni 1:18

(b) “...të cilën ASNJË NJERI nuk e ka parë KURRË...”

1 Timoteut 6:16

(c) “Dhe tha akoma :«TI NUK MUND TË SHIKOSH FYTYRËN TIME , sepse ASNJË NJERI NUK MUND TË SHIKOJË DHE JETOJË».

Ekzodi 33:20

Kundërshtim me :

(a) “Kështu Zoti fliste me Moisiun BALLË PËR BALLË, ashtu si flet një njeri me mikun e tij; ...”

Ekzodi 33:11

(b) “Pastaj Moisiu dhe Amroni, Nadabi dhe Abihy dhe shtatëdhjetë nga pleqtë e Izraelit u ngjitën, dhe PANË PERËNDINË E IZRAELIT...”

Ekzodi 24:10

(c) “Dhe kështu ai bekoi. Atëherë Jakobi e quajti këtë vend Peniel, sepse tha :« E PASHË PERËNDINË BALLË PËR BALLË DHE JETA IME U FAL».”

39. PERËNDIA – NUK ËSHTË SHKAKTARE E TRAZIRAVE, APO ...(?)

(a) “sepse Perëndia nuk është Perëndi TRAZIMI,…”

1 Korintinasve 14:33

kundërshtim me

(a) “...sjell mirëqenie dhe KRIJOI FATKEQËSINË. Unë Zoti i bëj të gjitha këto gjëra.”

Isaia 45:7

(b) “Fryma e Zotit ishte larguar nga Sauli dhe një FRYM I KEQ E TERRORIZONTE nga ana e Zotit”

1 Samuelit 16:14

(c) “E prandaj Perëndia do t`u dërgojë atyre një gënjim që do ti bëjë të gabojnë, që ti BESOJNË GËNJESHTRËS”

2 Thesalonikasve 2:11

40. PERËNDIA : KONTRADIKTA TË MËTEJME TË KUALITETEVE TË TIJ :-

Perëndi si qenie e plotfuqishme (Omnipotente)

“Por Jezusi (p.m.q.t), duke i ngulur sytë mbi ta, u tha:« Kjo për njerëzit është e pamundur, por jo për Perëndinë, sepse GJITHÇKA është e mundur për Perëndinë.”

Marku 10:27 gjithashtu Mateu 19:26

Kundërshtim me :

“Kështu Zoti mbajti anën e Judës, që dëboi banorët e Krahinës malore, por NUK MUNDI të dëbojë banorët e fushës, sepse kishin QERRE TË HEKURTA.”

Gjyqtarët 1:19

Zemërimi i Zotit zgjat për një çast (!) apo...(?)

“Sepse zepërimi im zgjat për NJË ÇAST, ... “

Psalmeve 30:5

kundërshtim me :

“Kështu zemërimi i Zotit u ndez kundër Izraelit; dhe ai bëri të enden DYZET VJET në shkretëtirë ...”

Numrat 32:13

Zoti nuk tregon asnjë vetë – qortim :

“Perëndia nuk është një njeri, që mund të gënjejë as edhe bir njeriu që mund të PENDOHEJ

Numrat 23:19

kundërshtim me :

“Samueli nuk shkoi për ta parë më Saulin deri ditën e vdekjes së tij, sepse Samueli mbante zi për Saulin; dhe Zoti u PENDUA që e kishte bërë Saulin mbret të Izraelit.”

1 Samuelit 15:35

Gjithashtu :

“Kështu Zoti NDRYSHOI MENDJEN (u pendua) lidhur me të keqen që kishte thënë se do ti bënte popullit të tij.”

Ekzodi 32:14

Mëshira e Zotit zgjatë përgjithmonë, apo...(?)

“Sepse Zoti është i mirë; mirësia e tij është e PËRJETSHME”

Psalmeve 100:5

kundërshtim me :

“Tani shko CAKTO SHFAROSJEN e të gjitha gjërave që kam pasur FARE MËSHIRË për të, por vrit burra dhe gra, fëmijë dhe foshnje gjiri, lopë e dhen, deve dhe gomarë”

1 Samuelit 15:3

Zoti jeton në dritë, apo ...(?)

“...dhe (Zoti) rri në dritë të paafuëshme, në të cilën asnjë njeri nuk e ka parë kurrë (prap kundërshtim, shiko 38. Perëndia) dhe as mund ta shohë...”

1 Timoteut 6:16

kundërshtim me :

“Atëherë Solomoni tha:« Zoti ka thënë se do të banojë në NJË RE TË DENDUR.»”

1 Mbretërve 8:12

[Në gjuhën angleze fjala “një re të dendur” nuk është fare por është “...dwell in the THICK DARKNESS...” e që në përkthim do të duhej të ishte “... në një ERRËSIRË TË DENDUR...”].

Zoti nuk tundon (provon) njerinë :

“Askush kur tundohet (provohet) të mos thojë :«Jam tunduar nga Perëndia», sepse Perëndia nuk mund të tundohet nga e keqja, dhe ai vet NUK TUNDON ASNJERI.”

Jakob 1:13

kundërshtim me :

“Mbas këtyre gjërave Perëndia e vuri NË PROVË ABRAHAMIN...”

Zanafilla 22:1

41. PERËNDIA – ME “P” TË VOGËL :

Në gjuhën Arabe, Hebraike dhe Greke nuk ka dallim në mes shkronjës “P” e madhe dhe atë “p” të vogël. Përkundër asaj – gjuhës së shteteve Perëndimore dhe fatmirësisht asaj Shqipe kur kemi shkronjë edhe të vogël edhe të madhe, edhe të shtypit edhe të shkrimit, akoma Krishterët kanë luajtur shpejtë dhe kanë humbur gjatë përkthimit të Biblës psh.

(a) “Të cilëve perëndia i këtij shekulli ua verboi mendjen...”

2 Korintasve 4:4

(b) “Zoti i tha Moisiut :«Shiko, unë po të bëj si perëndi për Faraonin, dhe vëllai yt Aaroni do të jetë profeti yt”

Eksodi 7:1

42. POLIGAMI – SOLOMONI I MENÇUR KISHTE MIJËRA GRA DHE KONKUBINA :

“Ai pati si bashkëshorte shtatëqind princesha dhe treqind konkubina; dhe bashkëshortet e tij ia çoroditën zemrën (drejtë zotrave tjerë).”

1 Mbretërve 11:3

Abrahami miku i Zotit kishte më shumë se një grua; dhe kështu ai pati Israelin (jakobin) dhe Davidin mbret.

Nuk ka asnjë fjalë në “Librin e Zotit” (Biblën e Shenjtë) kundër martesës me më shumë se një grua, kurse krishterët janë ata të cilët në emër të Librit të tyre të shenjtë na korigjojnë neve muslimanëve se nuk duhet të martohet njeriu me më shumë se një grua.

43. PROFECITË – KANOSJE TË ZBRAZËTA -

“Por mos ha nga pemja e njohjes të së mirës dhe së keqes, sepse DITËN që do të hash prej saj KE PËR TË VDEKUR ME SIGURI.”

Zanafilla 2:17

kundërshtohet me :

“Kështu Adami jetoi gjithsej NËNTËQIND E TRIDHJETË VJET dhe pastaj vdiq.”

Zanafilla 5:5

Çudi ! në gjuhën e Perëndisë “...ditën që do të hash...” a nuk don të thotë *po atë ditë* apo shekuj më vonë.

Bazuar në Biblën e Shenjtë dreqi ishte më i drejtë për kuptimin e të ngrënit të “*frytit të ndaluar*” kur ai i tha Evës :

“Atëherë gjarpëri (dreqi) i tha gruas :«Ju skeni për të vdekur aspak.»”

Zanafilla 3:4

44. PROFETËT (POR LAKURIQ) : NËSE KËSHU JANË PRIFTËRINJTË, ZOTI E BEKOFTË BRIMBULLIMIN E LIBRIT TË SHENJTË.

“Dhe ai (Noeu) piu verë e u deh, dhe u zhvesh në mes të çadrës së tij.”

Zanafilla 9:21

”Edhe ai (Sauli) i hodhi rrobat e tij dhe bëri PROFECI përpara Samuelit dhe qëndroi i shtrirë LAKURIQ për tokë tërë atë ditë dhe tërë atë natë. Prandaj dhuhet;« EDHE SAULI FIGURON MIDIS PROFETËVE ?»”

1 Samuelit 19:24

“...«Sa i nderuar ka qenë sot mbreti i Izraelit që u ZBULUA para syve të shërbëtorëve dhe shërbëtorëve të tij, ashtu siç do të zbulohet një harbut!»”

2 Samuelit 6:20

“Pastaj Zoti tha:« Ashtu si shërbëtori im Isaia shkoi LAKURIQ dhe zbathur gjatë tre vjetëve.»”

“ ...të rinj dhe pleq, lakuriq dhe të zbathur, vithezhveshur për turp të Egjiptit.”

Isaia 20:3-4

45. SABAT (E SHTUNE HEBRAIKE) SI FYERJE E PËRHERSHME E ZOTIT:

“... sepse në gjashtë ditë Zoti bëri qiellin dhe tokën, dhe ditën e shtatë PUSHOI DHE U SHLODH.»”

Ekzodi 32:17

Përkundrazi Kur`an-i i Shenjtë citon :

“Allahu është një, nuk ka Zot tjetër përveç Atij.

Ai është mbikqyrës i përhershëm dhe i përjetshëm
Atë nuk e kap as kotje as gjumë, gjithçka ka në
Qiej dhe në tokë është vetëm e Tij.

.....

Kursija e Tij përfshinë qiejt dhe tokën,
Kujdesi i tij ndaj të dyjave nuk i vjen rëndë ,
Ai është më i larti, më i madhi.

El Bekare 255

46. SARA – BIBLA E SHENJTË NUK E KURSEN AS PERËNDINË NGA SHPIFJET SEKSUALE TË PALIGJSHME QË I MVESHIN ATIJ :

Në rastin e nocionit të Jezu Krishtit (p.m.q.t) Zoti i Gjithfuqishëm ka rregulluar për Merin ta fitojë Jezusin me intervenim të Frymës së Shenjtë, që citohet në Bibël :

“... Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ty (pyetja është ,SI ?) dhe pushteti i Shumë të Lartit do të MBULOJË ME HIJEN E VET (prap pyetja, SI ?).

Lluka 1:35

Ndërsa në rastin e Isakut, nocioni i tij zë vend në mitrën e Sarës me intervenim direkt të Zotit, që është e shkruar në Librin e Librave :

“Zoti VIZITOI Sarën, siç i KISHTE THËNË;dhe Zoti I BËRI Sarës ato që i kishte premtuar”

“Dhe Sara U NGJIZ (nga Zoti ?) dhe lindi ...”

Zanafilla 21:1-2

47. SIDA DHE HOMOSEKSUALITETI - BIBLA E SHENJTË JEP SHKAK DHE ARSYE PËR KËTË KANCER DHE PARAZIT :

“Duke e deklaruar veten të urtë ,u bënë të marrë, dhe e shëndrruan lavdinë e Perëndisë së pakalbshme në një shembëllim të ngjashëm me atë të një njeriu të kalbshëm...”

“Prandaj Perëndia ia dorëzoi papastërtinë në epshet e aemrave të tyre, për të çnderuar trupat e tyre në mes vetë atyre (në Sodomi (Gay) dhe Lesbianizëm),

“Që e ndryshuan të vërtetën e perëndisë në një gënjeshtër dhe adhuruan dhe i shërbyen krijesës (lindja e gruas) në vend të krijesit që është i bekuar përjetë. Amen^{*}

“Prandaj perëndia i dorëzoi ata në pasione të ulëta (mashkull me mashkull dhe grua me grua); sepse edhe gratë e tyre i shëndrruan marëdhëniet e tyre natyrore në një që është kundër natyrës (shtazëri – njeri me shtazë – lesbianizëm).

“Në të njëjtën mënyrë burrat, duke lënë marëdhëniet e natyrshme me gruan, u ndezën në epshin e tyre për njëri – tjetrin, MASHKULL ME MASHKULL...”

(Bibla e Shenjtë) Romakëve 1:22-27

48. SKLLEVËRIA – E APROVUAR NGA ZOTI -

“Dhe mund t`ua lini trashëgim bijëve tuaj pas jush, si pronë e tyre; mund t`i shfrytëzoni SI SKLLEVËR për gjithnjë...”

Levitiku 25:46

49. SODOMI – ARSYEJA E BIBLËS SE PSE NJERËZIT JANË SHËNDRRUAR NË LESBEIKA DHE HOMOSEKSUALË.

Shiko Sida dhe Homoseksualiteti Romakëve 1:25-27

50. SYNËT – (RRETHPRERJE): MARRËVESHJE EPËRJETSHME ME ZOTIN :

“Do të rrethprietet (të bëhet synet) si ai që ka lindur në shtëpinë tënde, ashtu edhe ai që është blerë me para; besëlidhja (marrëveshja) ime me mishin tuaj do të jetë një BESLIDHJE E PËRJETSHME.”

Zanafilla 17:13

“Dhe mashkulli i parrethprerë, që nuk është rrethprerë në mishin e prepucit të tij, DO TË HIDHET JASHTË POPULLËT, SEPSE KA SHKELUR BESËLIDHJEN TIME.

Zanafilla 17:14

[Në gjuhën Angleze KJV “Të hidhet jashtë” nuk është fare por është “...to be CUT OFF...” e që do të duhej të ishte “të prehet, të jetë i mbytur”.]

51. TRINITI - SA I PËRKET BESIMIT TË ATHANASIT :

“Ati është Zot, Biri është Zot, dhe Fryma e Shenjtë është Zot, por nuk ekzistojnë tre Zotëra por një Zot.”

Në këtë Trinitë të Shenjtë : “Tre persona janë AQ TË BASHKUAR dhe AQ TË PËRJETSHËM : sikur të gjitha janë të pakrijuara dhe fuqi e pakufizua.”(The Catholic Encyclopedia)

Prandaj Trinitë konsiderohet të jetë : “Një Zot në tre persona”.

Është vetëm një verset në tërë Dorëshkrimin e Shenjtë i quajtur Bibla që padyshim përmban këtë dogmë Krishtere, dhe ajo është :

“Sepse tre janë ata që dëshmojnë mbi qiell : Ati, Fjala dhe Fryma e Shenjtë; dhe këto tre janë një.”

Letra e parë e apostullit Gjon 5:7

Dr.C.I.Scofield, D.D. përkrahur nga tetë të tjerë D.D. në futnotë të këtij verseti mendojnë :

“ËSHTË PAJTUAR PLOTËSISHT SE KY VERSET NUK KA AUTORE TË DORËSHKRIMIT DHE ËSHTË FUTUR NË KËTË DORËSHKRIM “

Fundamentalistët Krishterë ende mbajnë këtë shpifje ndërsa në të gjitha përkthimet modernë përfshirë *Revised Standard Version (RSV)* ky mashtrim fetar është fshirë paceremonialisht, prandaj pohuar këtë gënjeshtim (hedhje poshtë të citatit më lartë) Kur'an-ik :

“Gjithashtu bënë kufër ata që thanë: “Allahu është i treti i treve (*Trinitë*)”. S`ka në gjithësi tjetër pos Allahut, e nëse nuk pushojnë nga ajo që thanë (*tre zotëra*), do t`i kapë denim i dhembshëm, ata që nuk besuan prej tyre.

El maide 73

Falënderim Allahut të Madhërishëm. Krishterët domosdo po i hetojnë falsifikimet pagane në “*Librin e tyre të Zotit*”, por ata ende zvarrisin shputat e tyre.

52. VERA – SHIKO “ALKOOLIZMI” NË PËRMBAJTJE